LIGJ
Nr.7581, datë 7.7.1992

PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë çmimet dhe tarifat formohen mbi bazën e kërkesave të ligjeve të ekonomisë së tregut.

Neni 2

Çmimet dhe tarifat caktohen nga:
- Këshilli i Ministrave, për një pjesë të kufizuar artikujsh dhe shërbimesh, që janë bazë për nivelin e jetesës dhe për degë të veçanta të ekonomisë.
- Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj.

Neni 3

Këshilli i Ministrave, me krijimin e kushteve të përshtatshme ekonomike, liberalizon më tej çmime dhe tarifa të emërtesës së tij.

Neni 4

Këshilli i Ministrave cakton emërtesën dhe çmimet e tarifat që do të jenë në kompetencë të tij. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të interesuara, i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimet e çmimeve dhe tarifave që janë në kompetencë të tij.

Neni 5

Këshilli i Ministrave cakton kufij të njëjtë të çmimeve e të tarifave të detyrueshme për zbatim dhe nga personat juridikë a fizikë privatë, vendas ose të huaj, për mallrat dhe shërbimet në emërtesë të tij.

Këshilli i Ministrave vendos kontroll mbi çmimet e mallrave dhe shërbimeve monopol.

Neni 6

Shteti jep subvencione për diferenca çmimesh, në raste të veçanta dhe vetëm për artikujt e shërbimet bazë për nivelin e jetesës. Këto janë të përkohshme dhe përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

Neni 7

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse ndjekin zbatimin e çmimeve dhe të tarifave të caktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe merren me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në

fushën e çmimeve e të tarifave brenda sistemit, kurse organet lokale përkatëse të administratës shtetërore në rrethe merren me zgjidhjet e mosmarrëveshjeve dhe të zbatimit të çmimeve e të tarifave brenda rrethit.

Neni 8

Moszbatimi i çmimeve dhe i tarifave të caktuara nga Këshillii Ministrave, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë lekë për çdo rast nga policia financiare. Në raste të përsëritura dënohet edhe me sekuestrim të mallit e deri në mbylljen e aktivitetit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, përkatësisht te kryetari i degës së policisë financiare në rreth, ose drejtori i policisë financiare, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Fitimet spekulative të realizuara nga zbatimi i çmimeve më të larta nga ato të miratuara nga Këshilli i Ministrave, derdhen detyrimisht në buxhet sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Mjetet shtetërore të informacionit masiv, të bëjnë të njohur periodikisht indeksin e çmimeve të konsumit, që nxjerr Drejtoria e Statistikës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Neni 10

Ligji nr.7384, datë 8.5.1990 "Për çmimet dhe tarifat", shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.249, datë 14.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha